

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës
<b>Titulli i lëndës</b>	Kapituj të zgjedhur nga teoria e gjasës dhe statistika
<b>Niveli</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës</b>	Z
<b>Viti i studimeve</b>	III (Sem. VI)
<b>Numri i orëve në javë</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS</b>	5
<b>Koha / lokacioni</b>	Departamenti i Matematikës
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	dr. sc. Bujar Fejzullahu
<b>Detajet kontaktuese</b>	e-mail: bujar.fejzullahu@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Kursi jep konceptin mbi statistikat përshkruese, Statistika jo-parametrike, Permutacionet e rastit, Regresionin jolinear dhe linear, Simulimet, Seritë kohore, Procesin e Poisson-it, Statistika intensive kompjuterike etj..
<b>Qëllimet e lëndës</b>	
	Qëllimi i këtij kursi është që studentët të njihen me modelet themelore probabilitike dhe aplikimet e tyre në shkencat natyrore dhe shoqërore. Në mënyrë të veçantë, studentëve do tu prezantohen elementët e qasjeve statistikore në modelet e zgjedhura stokastike, si dhe me aplikimet e ndryshme të modelimit probabilitik në shkencë, si matematika financiare dhe biologjia molekulare.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>	
	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohin metoda të ndryshme statistikore dhe aplikojnë ato në fusha të ndryshme;</li> <li>• Identifikojnë statistikat jo-parametrike dhe testin e Kolmogorov-Smirnovit;</li> <li>• Kuptojnë parimet bazë të konkluzionit statistikor;</li> <li>• Përdorin testimet e permutacionit në statistika dhe problemin e datëlindjes;</li> <li>• Aplikojnë kontrollin e hipotezave të pritjes matematike dhe të dispersionit të një madhësie të rastit normale;</li> <li>• Analizojnë se ç'është korrelacioni dhe të vlerësojnë koeficientët e tij. Të kuptojnë vijat e regresionit;</li> <li>• Modelojnë ndodhitë e ngjarjeve dhe pikat kohore në të cilat ndodhin ngjarjet në një interval të caktuar përmes procesit të Poisson-it.</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>135</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Detyrat e shtëpisë (10%), Kollokuiumi i parë (15%), Kollokuiumi i dytë (15%), Testi final (60%). Kriteri i kalueshmrisë është mbi 50% të pikëve të përgjithshme të vlerësimit. Nëse studenti nuk e kalon provimin me kollokuiume dhe detyra të shtëpisë, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim që peshon 40%, si dhe provimit me gojë që peshon 60%. Kalimi i provimit me shkrim është i domosdoshëm për t'iu nënshtruar provimit me gojë.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	G. R. Grimmett, D. R. Stirzaker, Probability and random processes, Oxford University Press, 1992.		
<b>Literatura shtesë:</b>	D. Nolan, T. Speed, Stat Labs. Mathematical Statistics Through Applications, Springer Verlag, 2000. William W. Hines; Douglas C. Montgomery, Probability and Statistics in Engineering and Management Science, Wiley, 1992.		
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>			

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Statistikat Deskriptive
<i>Java e dytë:</i>	Statistika joparametrike
<i>Java e tretë:</i>	Permutacionet e rastit
<i>Java e katërt:</i>	Analiza korelative
<i>Java e pestë:</i>	Analiza regresive
<i>Java e gjashtë:</i>	Regresionin jolinear dhe linear
<i>Java e shtatë:</i>	Treguesit themelorë statistikore të vargjeve kohore
<i>Java e tetë:</i>	Indekset. Modelet prognozuese
<i>Java e nëntë:</i>	Simulimet
<i>Java e dhjetë:</i>	Seritë kohore
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Levizja e rastit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Proceset e Poisson-it
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Modelet probabilitare të vargjeve biologjike
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Qasja Bayess-it ndaj statistikave
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Statistika intensive kompjuterike

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.

## Algjebra Lineare I

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike:</b>	FSHMN		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Algjebra Lineare I		
<b>Niveli:</b>	Baçelor		
<b>Statusi lëndës:</b>	O		
<b>Viti i studimeve:</b>	I		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	3+3		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	8		
<b>Koha / lokacioni:</b>	Departamenti i Matematikës		
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Qëndrim Gashi		
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:gendrim.gashi@uni-pr.edu">gendrim.gashi@uni-pr.edu</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>			
	Kursi i kushtohet sistemeve të ekuacioneve lineare dhe nocioneve të afërta me to, si matricat, përcaktorët si dhe hapësirat vektoriale $R^n$ . Duke qenë se algjebra lineare ka shumë zbatime të rëndësishme në shumë fusha (si fizikë, inxhinieri, shkencat sociale, etj.), një kohë do të kalohet në zbatime të koncepteve të futura.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi kryesor i kursit është të përgatisë studentët të zgjidhin sistemet e ekuacioneve lineare përmes zbatimit të metodave të ndryshme përfshirë edhe zbatimin e matricave dhe vetive të tyre.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë dhe përdorin nocionet e matricave, përcaktorëve dhe vetitë e tyre për t'i studiuar sistemet e ekuacioneve lineare.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuime	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30

Përgatitja përfundimtare për provim final	1	6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	3	1	3
Projektet, prezantimet, etj.	1	15	15
<b>Totali</b>			<b>180</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime, projekte. Një pjesë e kursit do të jetë i invertuar ose gjysëm i invertuar.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	Pjesëmarrja (10%) Detyrat e shtëpisë (10%) Kollokuiumi i parë (15%) Kollokuiumi i dytë (15%) Projekti (15%) Testi final (35%)		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>			
	[1] G. Strang, Introduction to Linear Algebra, 5th ed. Wellesley, MA; Wellesley-Cambridge Press, 2016. [2] Q. Gashi, Shënime nga Algjebra lineare, dispensë, 2024. [3] E. Gashi, Algjebra I, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001.		
<b>Literatura shtesë:</b>			
	[4] S. Axler, <i>Linear Algebra done Right</i> , Springer-Verlag New York Inc.; 2nd ed. 1997. Corr. 7th printing 2004		

<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
1	Hyrje. Gjeometria e ekuacioneve lineare. Matricat. Metoda e eliminimit.
2	Shumëzimi dhe inversi i matricave. Faktorizimi LU. Permutacionet dhe transponimi.
3	Hapësirat e rreshtave dhe shtyllave. Bashkësia e zgjidhjeve të sistemit të ekuacioneve lineare.
4	Baza, dimensionimi. Nënhapësirat fundamentale.
5	Kollokuiumi i parë.
6	Projektimi. Metoda e katrorëve më të vegjël.
7	Ortogonaliteti. Teorema e Gram-Schmidt-it.
8	Përcaktorët dhe vetitë e tyre. I

<b>9</b>	Përcaktorët dhe vetitë e tyre. II
<b>10</b>	Transformimet lineare. I
<b>11</b>	Transformimet lineare. II
<b>12</b>	Kollokuiumi i dytë
<b>13</b>	Zbatime
<b>14</b>	Zbatime
<b>15</b>	Prezantim i projekteve.

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët duhet të vijnë me rregull dhe në kohë në ligjërata, ushtrime e provime. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të bisedojnë me kolegë në lidhje me detyrat me kushtin që shënohen emrat e kolegëve me të cilët është diskutuar dhe/ose resurset që janë përdorur.

**SYLLABUSI i lëndës: Algjebra lineare II**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës
<b>Drejtimi</b>	Arsimor
<b>Titulli i lëndës:</b>	Algjebra lineare II
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	E obligueshme
<b>Viti i studimeve:</b>	II(semestri III)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6
<b>Koha / lokacioni:</b>	Departamenti i Matematikës
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Dr. Sc. Muhib Lohaj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Tel.: (0) 44 220-015
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Në fillim do të punohen detyra ne mënyrë që të shpjegohen kuptimet dhe nocionet themelore të lëndës Hapësirat vektoriale. Do të punohen detyra të cilat shpjegojnë kuptimin e bazës dhe dimensionit të hapësirës vektoriale, pastaj do të jepet kuptimi i nënhapësirës dhe mbështjellësit linear . Tutje, do të punohen detyra ne lidhje me veprimet me nënhapësira . Pasi të jenë arritur këto objektiva do të vazhdohet me operatorët linearë dhe vetitë e tyre. Me kuptimin e matricës së operatorit linear dhe pastaj do të studjohet grupi i operatorëve regularë. Kështu do të arrihet një bazë e mjaftueshme për të studjuar pastaj nënhapësirat invariante dhe operatorët reducibil e plotësisht reducibil. Pastaj, vlerat vetjake dhe vektorët vetjakë dhe diagonalizimi i matricës përkatësisht operatorit. Pasi të jenë arritur këto qëllime do të studjohen nënhapësirat ciklike dhe polinomi minimal i vektorit.</p>

<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Mësimi i lëndës Algjebra lineare ka një rëndësi të madhe për përgatitjen e studentëve që me lehtësi të shpjegojnë shumë probleme të matematikës në shkollat e mesme. Gjithashtu, me studimin e Algjebres lineare studenti fiton një bazë elementare që të thellojë njohuritë e tij në këtë fushë si dhe në fushat tjera matematike si p.sh. Ekuacionet diferenciale të zakonshme dhe parcialet, Analizë numerike e posaqërisht në Analiz funksionale. Kjo lëndë gjithashtu luan një rol të veçantë për studimin e shumë shkencave si p.sh. shkencën e fizikës, shkencat kompjuterike si dhe shkencat teknike.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• vërtetojë nëse ndonjë strukturë algjebrike është hapësirë vektoriale,</li> <li>• gjejë bazën e hapësirave vektoriale,</li> <li>• njehsojë koordinatat e vektorëve në baza të ndryshme,</li> <li>• zgjidhë probleme konkrete duke shfrytëzuar matricën e operatorit linear,</li> <li>• gjejë vlerat vetjake dhe vektorët vetjakë,</li> <li>• gjejë polinomin minimal të operatorit(matricës),</li> <li>• identifikojë nënhapësirat invariante të operatorit linearë,</li> <li>• gjejë polinomin minimal të vektorit.</li> </ul>

### Kontributi në ngarkesën e studentit –Semestri III

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata me profesorin	2	15	30
Ushtrime me asistentin	2	15	30
Punë praktike			
Konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			

Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim			8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)			3
Projektet, prezantimet, etj			
<b>Totali</b>			<b>150</b>

**Metodologjia e mësimdhënies:** Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, kollokuiume, provime

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i parë (kollokuium): 20%</p> <p>Vlerësimi i dytë (kollokuium): 20%</p> <p>Vijimi i rregullt: 10%</p> <p>Detyrat e shtëpisë 10%</p> <p>Provimi final: 40%</p> <p>Total: 100%</p> <p>Nëse studenti nuk e kalon provimin me kollokuiume dhe detyra të shtëpisë, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim (50%), si dhe provimit me gojë (50%).</p>														
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Numri i pikëve</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0-49</td> <td>5 (nuk kalon)</td> </tr> <tr> <td>50-59</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>60-69</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>70-79</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>80-89</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>90-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> </tbody> </table>	Numri i pikëve	Nota	0-49	5 (nuk kalon)	50-59	6 (gjashtë)	60-69	7 (shtatë)	70-79	8 (tetë)	80-89	9 (nëntë)	90-100	10 (dhjetë)
Numri i pikëve	Nota														
0-49	5 (nuk kalon)														
50-59	6 (gjashtë)														
60-69	7 (shtatë)														
70-79	8 (tetë)														
80-89	9 (nëntë)														
90-100	10 (dhjetë)														

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në teorinë e hapësirave vektoriale. Baza dhe dimensionimi i hapësirës vektoriale
<i>Java e dytë:</i>	Koordinatat e vektorëve në hapësirën vektoriale
<i>Java e tretë:</i>	Nënhapësira. Mbështjellësi linear
<i>Java e katërt:</i>	Shuma e drejtëpërdrejt e nënhapësirave
<i>Java e pestë:</i>	Operatorët linearë. Hapësira e operatorëve linearë
<i>Java e gjashtë:</i>	Matrica e operatorit linear
<i>Java e shtatë:</i>	Grupi i operatorëve regularë
<i>Java e tetë:</i>	Nënhapësirat invariante. Operatorët reducibil dhe plotësisht reducibil
<i>Java e nëntë:</i>	Vlerat vetjake dhe vektorët vetjakë
<i>Java e dhjetë:</i>	Polinomi karakteristik i operatorit
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Polinomi minimal i operatorit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Diagonalizimi I matrices dhe operatorit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Nënhapësirat ciklike dhe polinomi minimal i vektorit
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Zbërthimi i hapësirës në shumë të drejtëpërdrejtë të nënhapësirave rrënjësore

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gashi E., Pupovci. D., Hapësirat vektoriale, Prishtinë, 1998,</li> <li>• Charles G.Cullen, Matrix and linear transformations, Canada, 1990,</li> <li>• Zhang.F., Matrix Theory, Springer-Verlag New York, 1999,</li> <li>• Caklovic L., Zbirka zadataka iz linearne algebre, Zagreb, 1985.</li> </ul>

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët duhet të vijojnë mësimin me rregull dhe duhet t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës. dhe rregullat e tjera të Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjiaturë, kopjim të testeve nga të tjerët, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test ose provim. Vijueshmëria e rregullt e studentit është obligative.

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
<b>Titulli i lëndës</b>	Analiza komplekse		
<b>Niveli</b>	Bachelor		
<b>Statusi lëndës</b>	I obligueshëm		
<b>Viti i studimeve</b>	III (Sem. VI)		
<b>Numri i orëve në javë</b>	3+2		
<b>Vlera në kredi – ECTS</b>	6		
<b>Koha / lokacioni</b>	Departamenti i Matematikës		
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	dr. sc. Bujar Fejzullahu		
<b>Detajat kontaktuese</b>	e-mail: bujar.fejzullahu@uni-pr.edu		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>			
	Ky kurs ofron një hyrje në teorinë e funksioneve të variablilit kompleks me aplikime.		
<b>Qëllimet e lëndës</b>			
	Studentët do të pajisen me kuptimet themelore të analizës komplekse, siç janë analiciteti, integrimi në rrafshin kompleks, reziduumi. Në veçanti, studentët do të fitojnë njohuri për integralin kompleks dhe përmes reziduumeve të njehësojnë integrale reale të komplikuar.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>			
	Pas përfundimit me sukses të kursit, studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>manipuloj me numrat kompleks në trajtat e tij të ndryshme, të përcaktoj kuptimet themelore topologjike në kontekstin e rrafshit kompleks;</li> <li>përshkruajë dhe zbatojë kuptimet e funksioneve analitike e harmonike dhe pasqyrimin konformal;</li> <li>formulojë dhe përdorë teoremat integrale të Cauchy-t;</li> <li>identifikojë, klasifikojë zerot dhe polet e funksioneve si dhe të gjejnë reziduomet e tyre;</li> <li>njuhsojë integrale të caktuara reale duke përdorur metoda analitike komplekse.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15

Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	-	-	-
<b>Totali</b>			165

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuime, provime.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Detyrat e shtëpisë (10%), Kollokuimi i parë (15%), Kollokuimi i dytë (15%), Testi final (60%). Kriteri i kalueshmrisë është mbi 50% të pikëve të përgjithshme të vlerësimit. Nëse studenti nuk e kalon provimin me kollokuime dhe detyra të shtëpisë, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim që peshon 40%, si dhe provimit me gojë që peshon 60%. Kalimi i provimit me shkrim është i domosdoshëm për t'iu nënshtruar provimit me gojë.
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	L. V. Ahlfors, <i>Complex analysis</i> , McGraw-Hill, New York, 1979.
<b>Literatura shtesë:</b>	E. Bajrami dhe D. Kalaj, <i>Analizë komplekse-Përmbledhje detyrash</i> , Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2023. W. Rudin, <i>Real and Complex Analysis</i> , McGraw-Hill, New York, 1987.

<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë</i>	Numrat kompleks. Topologjia e rrafshit kompleks.
<i>Java e dytë</i>	Vargjet dhe seritë e numrave kompleks.
<i>Java e tretë</i>	Funksioni i variablit kompleks. Limiti dhe vazhdueshmëria e funksionit kompleks.
<i>Java e katërt</i>	Derivimi dhe ekuacionet e Cauchy-Riemann-it. Funksionet analitike
<i>Java e pestë</i>	Vargjet dhe seritë funksionale. Seritë polinomiale
<i>Java e gjashtë</i>	Pasqyrimi konform dhe transformimi bilinear

<i>Java e shtatë</i>	Funksionet elementare: polinomet dhe funksionet racionale
<i>Java e tetë</i>	Funksionet elementare: funksionet eksponenciale, trigonometrike, logaritmike
<i>Java e nëntë</i>	Integrimi në rrafshin kompleks. Teorema integrale e Cauchy-it
<i>Java e dhjetë</i>	Formula integrale e Cauchy-it dhe rrjedhime të tij.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Seria e Taylor-it. Seria e Laurent-it
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Zerot dhe singularitetet
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Teorema e mbetjeve (reziduomet) dhe aplikimi i tij në njehësimin e integraleve
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Njehësimi i integraleve të caktuara reale me anë të reziduumeve
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Zgjerimi analitik

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.

SYLLABUSI i lëndës: Analiza matematike II (Drejtimi I matematikes)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN (Departamenti i Matematikës - Drejtimi i matematikës), Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Analiza matematike II
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-të
Numri i orëve në javë:	3+3
Vlera në kredi – ECTS:	9
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Naim Braha
Detajet kontaktuese:	nbraha@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve që të fitojnë njohuritë themelore në lidhje me konceptin e integralit të pacaktuar, integralit të caktuar si sipërfaqe dhe sipërfaqe të një figure rrafshore, zbatimet e integraleve në njehsimet të gjatësive të vijave rrafshore, vëllimin dhe sipërfaqen e trupave rrotullues, integralet jo të veta, kuptimi I serive polinomiale dhe disa kuptime themelore nga hapësirat metrike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet themelore janë të njohuritë dhe të dhënat e njehsimit integral me zbatime si dhe metodat e pafundme të njehsimeve të integraleve. Në këtu nënkuptohet njohuritë nga integralet e pacaktuara të caktuara, jo të veta, serive polinomiale dhe disa elemente të hapësirave metrike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: 1. që të ketë njohuri mbi integralet e pacaktuara 2. që të ketë njohuri mbi integralet e caktuara dhe zbatimet praktike të tyre 3. që të ketë njohuri mbi integralet jo të veta me zbatime 4. të dije zberthimin e funksioneve në seri polinomiale 5. të zbatojë zberthimin në seri polinomiale për njehsim të integraleve 6. të dije kuptimet themelore nga hapësirat metrike
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Testet periodike, seminare	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	6	15	90
Ngarkesa totale orë			188
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	Ligjërata, diskutime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, konsultime në grupe apo individuale, ushtrime teorike, teste periodike, provimi final.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	Vijimi në mësim dhe aktiviteti 5% Detyrat e shtëpisë 10% Testi i parë 40% Testi i dytë 45% Ose provimi final qe ka 85%		
<b>Literatura</b>			
Literatura bazë:	Brian S. Thomson, Judith B. Bruckner, Andrew M. Bruckner: Elementary real analysis, thomson, 2001. (e preferuare) N. Braha dhe I. Shehu, Analiza matematike I, Prishtine, 2006(e preferuare) K. Bukuroshi, analiza Matematike I, Tirane , 1977.		
Literatura shtesë:	<i>William Trench, Real Analysis, 2012</i> <i>G.M.Fihtengolz, Matemateski Analiz, Tom, I, II, III</i> Walter Rudin, Principles of mathematical analysis, McGraw-Hill, 1976. V.Zorich, Mathematical Analysis 1,2, Springer, 2004		
<b>Java</b>			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	kuptimi i integralit te pacakture dhe vetite themelore		
<i>Java e dytë:</i>	metodat e zevendesimit dhe parciale		
<i>Java e tretë:</i>	integralet racionale		
<i>Java e katërt:</i>	Integralet iracionale		
<i>Java e pestë:</i>	integralet trigonometrike dhe ato transcendente		
<i>Java e gjashtë:</i>	definimi dhe veti te integralit te caktuara		

<i>Java e shtatë:</i>	klaset e funksioneve te integrueshme
<i>Java e tetë:</i>	formula e Njuten-Laibnicit dhe zbatimet e saj
<i>Java e nëntë:</i>	kuptimi i integralit jo te vete dhe vetite
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>disa kriteret te konvergjes se integraleve jo te veta</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	serite funksionale, konvergjenca e tyre dhe kriteret e konvergjences
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>serite polinomiale me zbatime</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	kuptimi i hapësirave metrike
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	konvergjenca, plotesia, vazhdueshmeria
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kompaktesia , lidhmeria

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijueshmeria ne ligjerata dhe ushtrime eshte e obligueshme, nuk lejohet perdorimi i mjeteve elektronike si telefoni dhe te tjera. Nese studenti mungone me shume se 4 here ne ligjerata apo ushtrime e ndegjone lenden perseri vitin tjeter. Mos disiplinore ndeshkohet me masa disiplinore te parapara me statut te Universitetit te Prishtines

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
<b>Titulli i lëndës</b>	Analizë matematike I		
<b>Niveli</b>	Bachelor		
<b>Statusi lëndës</b>	I obligueshëm		
<b>Viti i studimeve</b>	I (Sem. I)		
<b>Numri i orëve në javë</b>	3+3		
<b>Vlera në kredi – ECTS</b>	8		
<b>Koha / lokacioni</b>	Departamenti i Matematikës		
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	dr. sc. Bujar Fejzullahu		
<b>Detajet kontaktuese</b>	e-mail: bujar.fejzullahu@uni-pr.edu		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohja me numrat realë, funksionet reale dhe të kuptimeve që lidhen me të. Kursi përfshinë bashkësitë dhe algjibrën e funksioneve, sistemi aksiomatik i numrave real, numrat kardinal, funksionet elementare algjebrike dhe transcendentë, vargjet numerike, limit, vazhdueshmëria dhe derivueshmëria e funksionit.		
<b>Qëllimet e lëndës</b>	Qëllimi i kursit është pajisja e studentëve me njohuri themelore për bashkësitë numerike, funksionet dhe vetitë e tyre, funksionet elementare, vargjet numerike dhe konvergjencën e tyre, limitin e funksioneve, vazhdueshmërinë e funksioneve, njehsimin diferencial.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• kuptojnë sistemin aksiomatik të numrave realë dhe mbi bazën e tyre të ndërtoj bashkësinë <math>\mathbb{R}</math>;</li> <li>• përshkruajnë vetitë e funksioneve reale elementare;</li> <li>• analizojnë dhe shpjegojnë konvergjencën e vargjeve numerike;</li> <li>• njehësojnë limitet e funksioneve;</li> <li>• analizojnë dhe aplikojnë kuptimin e vazhdueshmërisë për funksionet algjebrike dhe transcendentë;</li> <li>• të kuptojnë dhe zbatojnë njohuritë nga njehsimi diferencial.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45

Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>195</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Detyrat e shtëpisë (10%), Kollokuiumi i parë (15%), Kollokuiumi i dytë (15%), Testi final (60%). Kriteri i kalueshmrisë është mbi 50% të pikëve të përgjithshme të vlerësimit. Nëse studenti nuk e kalon provimin me kollokuiume dhe detyra të shtëpisë, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim që peshon 40%, si dhe provimit me gojë që peshon 60%. Kalimi i provimit me shkrim është i domosdoshëm për t'iu nënshtruar provimit me gojë.
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	V. Zorich, <i>Mathematical Analysis I</i> , Springer Verlag, Berlin, 2016.
<b>Literatura shtesë:</b>	M. Berisha dhe R. Zejnullahu, <i>Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Analiza matematike I</i> , Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1987. C. Canuto and A. Tabacco, <i>Mathematical Analysis I</i> , Springer Verlag, Milano, 2008.

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Bashkësitë dhe funksionet
<i>Java e dytë:</i>	Sistemi aksiomatik i numrave realë.
<i>Java e tretë:</i>	Rrjedhime të aksiomave të numrave realë
<i>Java e katërt:</i>	Tri lemat themelore të analizës matematrike
<i>Java e pestë:</i>	Interpretimi gjeometrik i bashkësisë së numrave realë. Vlera

	absolute e numrave realë.
<i>Java e gjashtë:</i>	Numrat kardinal
<i>Java e shtatë:</i>	Vargjet numerike – përkufizimi dhe vetitë elementare. Konvergenca. Vetitë e vargjeve konvergjente. Rregullat e kalimit.
<i>Java e tetë:</i>	Vargjet e Koshit. Numri $e$ .
<i>Java e nëntë:</i>	Funksionet elementare. Vetitë elementare të funksioneve
<i>Java e dhjetë:</i>	Vlera kufitare e funksionit.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Vazhdueshmëria, vazhdueshmëria uniforme dhe pikat e këputjes.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Derivati, interpretimi gjeometrik dhe mekanik. Derivati dhe vazhdueshmëria.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Rregullat për gjetjen e derivatit, derivatet e funksionit të përbërë dhe funksionit invers. Derivatet e funksioneve elementare.
<i>Java e katëmbëdhjetë:</i>	Teoremat themelore të njehsimit diferencial.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Zbatimi i njehsimit diferencial në paraqitjen grafike të funksionit.

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.

## Bazat e të dhënave

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike:</b>	Matematikë / BSc Matematikë		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Bazat e të dhënave		
<b>Niveli:</b>	BSc		
<b>Statusi lëndës:</b>	Zgjedhore		
<b>Viti i studimeve:</b>	2		
<b>Numri i orëve/javë:</b>	2+2		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5		
<b>Koha / lokacioni:</b>	Sipas orarit të publikuar		
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof. Asoc. Dr. Ermir Rogova		
<b>Detajet kontaktuese:</b>	ermir.rogova@uni-pr.edu		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<i>Përpunimi dhe njohja me elementet themelore të bazave të të dhënave, format e paraqitjes së të dhënave, baza relacionale, algjebra relacionale, njohuritë themelore në SQL, procedurat e ruajtura, funksionet, normalizimi i bazës së të dhënave, bazat e të dhënave gjysmë të strukturuara (JSON, XML).</i>		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Dizajnimi i bazës relacionale, njohuri mbi urdhërat DDL, urdhërat DML, tipet e të dhënave, nënpyetsorët, normalizimi i bazës, elementet themelore në JSON dhe XML, transaksionet, QBE (query by example), operatorët logjik, aritmetik, JDBC-ja, ODBC-ja.</i>		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><i>Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jetë në gjendje që të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të dijë të dizajnojë një bazë të të dhënave</i></li> <li>• <i>Që të dijë të manipulojë me elementet e algjebërës relacionale</i></li> <li>• <i>Të dijë të manipulojë me urdhërat themelore në SQL</i></li> <li>• <i>Të bëjë normalizimin e bazës së të dhënave</i></li> <li>• <i>Të dijë të ndërtojë bazë të të dhënave në JSON dhe XML, si dhe të ndërtojë pyetësorë në XPath dhe XQuery.</i></li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
<b>Ligjërata</b>	2	15	30
<b>Ushtrime teorike/laboratorike</b>	2	15	30
<b>Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet</b>	1	10	10
<b>Kollokfume,seminare</b>	1	6	6
<b>Koha e studimit vetanë të studentit</b>	3	15	45
<b>Projektet,prezentimet ,etj</b>	4	1	4
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<i>Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike, konsultime, detyra shtëpie, teste dhe provime.</i>		

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<i>Puna praktike: 30%, Testi i parë: 20%, Testi i dytë: 20%, Testi i tretë: 20%, Provimi final: 10%.</i> <i>Skema e notimit:</i> <i>Piket Nota</i> <i>0-49 5</i> <i>50-61 6</i> <i>62-73 7</i> <i>74-85 8</i> <i>86-97 9</i> <i>98-100 10</i>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Database Systems: Design, Implementation, &amp; Management 13th edition, Carlos Coronel, Steven Morris, Cengage Learning, 2018</i></li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Database System Concepts, Avi Silberschatz, Henry F. Korth, S. Sudarshan, McGraw Hill, 2019</i></li> <li>• <i>Essential SQL on SQL Server 2008, Sigha Bagui, Richard Earp, Jones and Bartlett, 2011</i></li> <li>• <i>Database Management Systems, Raghuram Ramakrishnan and Johannes Gehrke, McGraw-Hill, 2007</i></li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java 1:</b>	<i>Njoftim me lëndën, materialin dhe metodat e vlerësimit</i>
<b>Java 2:</b>	<i>Njoftim me bazat e të dhënave</i>
<b>Java 3:</b>	<i>Modeli relacional dhe Entity-relationship</i>
<b>Java 4:</b>	<i>Algebra relacionale</i>
<b>Java 5:</b>	<i>Dizajnimi i databazës</i>
<b>Java 6:</b>	<i>Normalizimi i databazës</i>
<b>Java 7:</b>	<i>SQL urdhërat DDL</i>
<b>Java 8:</b>	<i>Manipulimi i të dhënave, urdhërat DML</i>
<b>Java 9:</b>	<i>Urdhërat për shikimin e të dhënave</i>
<b>Java 10:</b>	<i>Përdorimi i operatorëve dhe funksioneve të ndryshme, Tipet e të dhënave në SQL</i>
<b>Java 11:</b>	<i>Lidhjet Join, Natural Join, Left/Right Outer Join dhe nënpyetsorët</i>
<b>Java 12:</b>	<i>Diagrami ER</i>
<b>Java 13:</b>	<i>Databazat OO, XML dhe JSON</i>
<b>Java 14:</b>	<i>Zhvillimi i databazave për web</i>
<b>Java 15:</b>	<i>Rishikim dhe përgatitje për provimin final</i>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
Në pajtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes të caktuara nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.	



**SYLLABUSI i lëndës:** Diferencialet e funksioneve me shumë ndryshore

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	FSHMN (Departamenti i Matematikës-Drejtimi i Përgjithshëm), Universiteti i Prishtinës
<b>Titulli i lëndës:</b>	Diferencialet e funksioneve me shumë ndryshore
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	II-të
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6
<b>Koha / lokacioni:</b>	FShMN
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Dr. Sc. Behar Baxhaku
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Behar.baxhaku@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve që të përforcojnë dhe dukshëm zgjerojnë njohuritë nga analiza matematike.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	Kursi Diferencialet e funksioneve me shumë ndryshore është vazhdim i kurseve Analiza matematike I e Analiza matematike II, të dëgjuara në vitin e parë të studimeve. Në të jepen kuptime të reja dhe përgjithësohen ato të njohura nga hapësira njëdimensionale në atë dy, tri e $m$ - dimensione. Qëllimi i kursit është vazhdimi i krijimit të një baze solide për të kuptuar materialin nga analiza matematike, e cila paraqet themelin e lëndëve nga analiza edhe në studimet Master dhe e cila është një prej shtyllave themelore për formësimin e matematikanit e pedagogut të ri.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
	Rezultatet e pritura të nxënies Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"><li>• njehë kuptimet dhe rezultatet themelore të vargjeve e serive funksionale, kuptimin hapësirave metrike dhe të bashkësive në to, të funksioneve me shumë ndryshore;</li><li>• krahasojë kuptimet dhe rezultatet themelore të vargjeve (serive) funksionale me ato të vargjeve (serive) numerike;</li><li>• dallojnë kuptimet dhe rezultatet themelore të funksioneve me shumë</li></ul>

	<p>ndryshore me ato me një ndryshore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zgjidhë detyra të ndryshme teorike e praktike nga përmbajtja e lëndës;</li> <li>• zbatojë serite Fourie;</li> <li>• gjejë vlerat ekstreme te funksioneve me shume ndryshore dhe aplikojë ato ne optimizim.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata me profesorin	2	15	30
Ushtrime me asistentin	2	15	30
Punë praktike			
Konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	3	1	3
Projektet, prezantimet, etj			
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime gjatë ligjëratarave, konsultime në grupe apo individuale, kolokuime, provime.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokuium): 45% Vlerësimi i dytë (kolokuium): 45% Vijimi i rregullt dhe aktiviteti ne mesim 10% Total: 100%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	[1] Vladimir Zorich, <i>Mathematical Analysis II</i> [2] Minir Efendija, <i>Analiza III</i> , Universiteti i Prishtinës, 2005;		
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>William Trench, Real Analysis, 2012</i> <i>G.M.Fihtengolz, Matemateski Analiz, Tom, I, II,</i>		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Njoftim me kursin Analiza matematike III. Konvergjencia dhe konvergjencia uniforme e vargjeve dhe serive funksionale
<b>Java e dytë:</b>	Kriteret Dirihlesë e Abelit për konvergjencën uniforme të vargjeve e serive funksionale.
<b>Java e tretë:</b>	Vetitë e vargjeve e serive uniformisht konvergjente
<b>Java e katërt:</b>	Seritë polinomiale.
<b>Java e pestë:</b>	Seritë polinomiale (vazhdim). Shembuj.
<b>Java e gjashtë:</b>	Kuptimi i metrike dhe hapësirave metrike
<b>Java e shtatë:</b>	Bashkesite ne hapësirat metrike
<b>Java e tetë:</b>	Seritë trigonometrike Furie
<b>Java e nëntë:</b>	Hapësira $\mathbf{R}^m$ . Disa nënbashkësi të rëndësishme të hapësirës $\mathbf{R}^m$
<b>Java e dhjetë:</b>	Kuptimi i funksionit me $m$ ndryshore. Konvergjencia e vargjeve në $\mathbf{R}^m$ . Limiti i funksionit me $m$ ndryshore. Limitet e përsëritura.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Vazhdueshmëria e funksionit me $m$ ndryshore. Shembuj.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Diferencimi i funksioneve me $m$ ndryshore.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Derivatet dhe diferencialet e rendeve të larta. Formula e Tejlorit për funksionet me shumë ndryshore. Shembuj.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Ekstremumet e funksioneve me shume ndryshore
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Ekstremumet e kushtëzuara.

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Vijimi i rregullt në ligjërata e ushtrime i obligueshëm (me tri mungesa të paarsyeshme nuk merret nënshkrimi). Në sallën e mësimit studentët duhet të gjenden para fillimit të ligjëratës. Respektimi i Statutit e Universitetit të Prishtinës dhe rregullave tjera të Universitetit e Fakultetit. Po ashtu, përdorimi i celularëve apo mjeteve tjera elektronike që e pengojnë procesin e mësimit, do të jetë i ndaluar.

**SYLLABUSI i lëndës: Ekuacionet diferenciale të zakonshme**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës
<b>Drejtimi</b>	Arsimor
<b>Titulli i lëndës:</b>	Ekuacionet diferenciale të zakonshme
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	E obligueshme
<b>Viti i studimeve:</b>	III(semestri V)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	3+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	7
<b>Koha / lokacioni:</b>	Departamenti i Matematikës
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Dr. Sc. Muhib Lohaj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Tel.: (0) 44 220-015
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Në fillim studentët do të njihen me kuptimet e përgjithshme të ekuacioneve diferenciale. Do të vërtetohet teorema fundamentale e teorisë së ekuacioneve diferenciale të zakonshme ( teorema e ekzistencës dhe e unicitetit të zgjidhjes). Tutje, do të studjohen ekuacionet diferenciale të rendit të parë të zgjidhshme me anë të kuadraturave. Pasi të arrihen aftësitë e mjaftueshme lidhur me problemet e përmendura do të studjohen zgjidhjet singulare të një ekuacioni diferencial. Si raste speciale do të diskutohen ekuacioni i Lagranzhit dhe Kleros. Në fazën e ardhshme në mënyrë të natyrshme do të kalohet në lidhjen e sistemeve me ekuacionet diferenciale të rendeve të larta. Tutje, do të studjohen ekuacionet diferenciale të rendeve të larta.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Mësimi i lëndës Ekuacionet diferenciale të zakonshme ka një rëndësi fundamentale për studimin e mëtutjeshëm jo vetëm të matematikës por edhe shumë fushave tjera posaqërisht të

	Shkencës së fizikës dhe Shkencave teknike. Në thellimin e mëtejshëm të dijes kjo lëndë luan një rol të veçantë për studimin e ekuacioneve diferenciale parcialet si dhe për studimin e shumë problemeve të analizës numerike.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhë ekuacionet diferenciale të rendit të parë me anë të kuadraturave</li> <li>• Zgjidhë ekuacionet diferenciale tek të cilat mund të bëjhet ndarja e ndryshoreve;</li> <li>• Identifikojë dhe zgjidhë ekuacionet homogjene, ekuacionet lineare, ekuacionet ekzakte, ekuacionin e Bernoulli-të, ekuacionin e Riccati-të),</li> <li>• Zgjidhë ekuacionet me metodën e diferencimit,</li> <li>• Zbatojë teoremën e unicitetit dhe ekzistencës në probleme konkrete,</li> <li>• Përshkruaj zgjidhjet singulare</li> <li>• Gjejë ekuacionin e trajektoreve izogonale dhe ortogonale të familjes së dhënë të lakoreve,</li> <li>• Zgjidhë ekuacionet diferenciale të rendeve të larta.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit –Semestri VII</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata me profesorin	3	15	45
Ushtrime me asistentin	2	15	30

Punë praktike			
Konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak	4	8	32
Përgatitja përfundimtare për provim			15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)			6
Projektet, prezantimet, etj			
<b>Totali</b>			<b>192</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b> Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, kollokuiume, provime															
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i parë (kollokuium): 20%</p> <p>Vlerësimi i dytë (kollokuium): 20%</p> <p>Vijimi i rregullt: 10%</p> <p>Detyrat e shtëpisë 10%</p> <p>Provimi final: 40%</p> <p>Total: 100%</p> <p>Nëse studenti nuk e kalon provimin me kollokuiume dhe detyra të shtëpisë, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim (50%), si dhe provimit me gojë (50%).</p> <table border="1" data-bbox="565 1325 995 1724"> <thead> <tr> <th>Numri i pikëve</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0-49</td> <td>5 (nuk kalon)</td> </tr> <tr> <td>50-59</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>60-69</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>70-79</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>80-89</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>90-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> </tbody> </table>	Numri i pikëve	Nota	0-49	5 (nuk kalon)	50-59	6 (gjashtë)	60-69	7 (shtatë)	70-79	8 (tetë)	80-89	9 (nëntë)	90-100	10 (dhjetë)
Numri i pikëve	Nota														
0-49	5 (nuk kalon)														
50-59	6 (gjashtë)														
60-69	7 (shtatë)														
70-79	8 (tetë)														
80-89	9 (nëntë)														
90-100	10 (dhjetë)														

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Kuptimet e përgjithshme të ekuacioneve diferenciale

<b>Java e dytë:</b>	Teorema e ekzistencës dhe e unicitetit
<b>Java e tretë:</b>	Ndarja (separacioni) i ndryshoreve . Ekuacionet homogjene
<b>Java e katërt:</b>	Ekuacionet diferenciale ekzakte. Faktori integrues
<b>Java e pestë:</b>	Ekuacionet lineare të rendit të parë dhe ekuacioni i Bernoulli-t
<b>Java e gjashtë:</b>	Ekuacioni i Riccati-të. Shqyrtime të tjera të ekuacionit $F(x, y, y')$
<b>Java e shtatë:</b>	Zgjidhjet singulare
<b>Java e tetë:</b>	Ekuacioni i lagranzhit dhe i Kleros
<b>Java e nëntë:</b>	Trajektoret izogonale dhe ortogonale
<b>Java e dhjetë:</b>	Ekuacionet diferenciale të rendeve të larta dhe lidhja me sisteme. Integralet e para dhe të ndërmjetme
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Ekuacionet diferenciale lineare të rendit $n$ me koeficientë të ndryshueshëm
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Përcaktori i Vronskit dhe aplikimet e tij
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Ekuacionet lineare johomogjene. Metoda e Lagranzhit
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Ekuacionet diferenciale lineare homogjene. Shqyrtimi i zgjidhjeve në varësi të ekuacionit karakteristik
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Zgjidhja e ekuacioneve diferenciale lineare johomogjene.

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merovci Y., Ekuacionet diferenciale të zakonshme, Prishtinë, 1983,</li> <li>• Ravi P.Agarwal, Donal O'Regan., An Introduction to Ordinary Differential Equations, New York 2008,</li> <li>• Hartman, Ph., Ordinary differential equations, New York, London, Sydney, 1964.</li> <li>• Fedorjuk, M.V., Obiknovenie differencialnie uravnenija, Nauka, Moskva, 1970.</li> </ul>

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët duhet të vijojnë mësimin me rregull dhe duhet t'i kontribuojnë atmosferës kolegiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës. dhe rregullat e tjera të Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjiaturë, kopjim të testeve nga të tjerët, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test ose provim. Vijueshmëria e rregullt e studentit është obligative.

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Fizika
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	3
Numri i orëve në javë:	2+2+0
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Marte 12 <sup>30</sup> -14 <sup>00</sup> /Salla 46
Mësimdhënësi i lëndës:	Sefer Avdiaj
Detajet kontaktuese:	044 609 918, <a href="mailto:sefer.avdiaj@uni-pr.edu">sefer.avdiaj@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<i>Studimi i fizikes nga studentet e matematikes iu krijon atyre mundësi qe te shohin aplikimin e matematikes ne fusha te ndryshme te fizikes dhe po ashtu studentet njihen edhe me arsyen e lindjes se shume ideve matematike duke u nise nga parimet fizike. Ne kuader te lendes do te analizohen konceptet si: forca, fusha, potenciali, energjia, temperatura, kufizimi kuantik (diskretizimi).</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Të rriten njohuritë e studenteve nga fizikës me shembuj te caktuar ku studentet gjithashtu mësojnë rreth metodave të ndryshme të matjes së madhësive fizike. Studimi se si nga matjet mund te perfitohen ligjet e natyres -fizikes. Aplikimi i njehesimit diferencial ne fizike. Lidhja ne mes te madhesive mekanike dhe termodinamike, ligjet e ruajtjes ne nayre. Po ashtu te rriten njohuritë dhe të kuptuarit e njohurive themelore të forcave midis atomeve dhe molekulave. Njohja e dukurive në natyrë, lidhur me valët elektromagnetike. Zotërimi i koncepteve dhe parimeve bazë të relativitetit special.</i>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<i>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që: Dije dhe kuptoje: konceptet e forces, fushes potecialit, energjise, temperatures, modelimit ne fizike. Te bej lidhjen ne mes te madhesive te ndryshme nga pjese te ndryshme te fizikes. Zbatoje: Dija e fituar ne fizike mund te perdoret per formulimin (ndertimin) e shembujve per perdorimin e modeleve matematike (sistemet e ekuacioneve lineare,</i>

	<p>derivateve, integraleve etj). Po ashtu te zbatoje dijen e fituar ne kryren e eksperimenteve dhe analizimin e te dhenave duke perfshire papercaktuesmerite ne matje.</p> <p><i>Reflektaje:</i> ne perdorimin e casjes dhe formalizmit matematike ne shembuj konkret te fizikes.</p> <p><i>Transferoje dijen:</i> ne metodologji te perodimit te teorive fizike per observimin e fenomeneve ne natyre: ndertoje modele teorike, te definoje madhesite fizike dhe variablate qe shfaqen en model dhepastaj keto ti krahasoj me vlerat e matura te madhesive.</p>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	2/13 (UN) 2/2	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	2/15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume, seminare	2		4
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	2/15	60
Përgaditja përfundimtare për provim	/	/	40
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	/	6
Projektet,prezentimet ,etj	2	/	4
<b>Totali</b>	<b>14.5</b>	<b>/</b>	<b>189</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	<i>Mënyra frontale – tradicionale, ushtrime, detyra shtepie, konsultime</i>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	<i>Dy teste(kolofiume) dhe provimi final. Provimi me shkrim është eliminues. Dy ushtrime laboratorike jane obligative te kryhen dhe te perpunohen.</i>		
<b>Literatura</b>			

<b>Literatura bazë:</b>	<i>Autoret:</i> Michael Mansfield & Colm O'Sullivan <i>Libri:</i> Understanding Physics, Second Edition, 2011
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>Autoret:</i> Halliday, Resnick, Walker, <i>Libri:</i> Fundamentals of Physics, 10 <sup>th</sup> Edition, 2014

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Njohja me programin e lendes. Kuptimi i universit fizik. Bashkeveprimet dhe grimcat elementare.
<b>Java e dytë:</b>	Hyrje dhe koncepte matematike, Përdorimi i matematikës në fizikë (përdorimi i derivimit dhe integritit). Përdorimi i variablave për paraqitjen e të dhënave.
<b>Java e tretë:</b>	Shkaktaret e levizjes: dinamika. Koncepti i forcës dhe ligjet e Newtonit. Lekundjet.
<i>Java e shtatë:</i>	paraqitja e shprehjeve matematike ne Latex
<i>Java e tetë:</i>	vizatimi i figurave ne latex
<i>Java e nëntë:</i>	importimi i figurave ne formatin “bmp” dhe “eps”
<i>Java e dhjetë:</i>	pershtatja e rrethines punuese
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	shenimet e headersave
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	thirrja e paketave te Latex-ut si “ams” etj
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	shenimet e diagrameve te ndryshme si ato te paketes “xy” dhe pstricks
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	shenimet e ndryshme te bibliografise
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	pershtatja e butonave ne tekst editorin “winshell”.

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
Vijueshmeria ne ligjerata dhe ushtrime eshte e obligueshme

## Programimi I

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Programimi I		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I-rë		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Faton Berisha		
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:faton.berisha@uni-pr.edu">faton.berisha@uni-pr.edu</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>			
	Kjo lëndë përfshinë pjesë të ndërtimit të algoritmave dhe pjesë të programimit bazik në gjuhën programuese Java.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>			
	Paisja e studentëve me njohuri themelore mbi programimin e orientuar nga objektet, strukturën e komponenteve dhe strukturën e kontrollit në Java. Aftësimi për programim të aplikacioneve të thjeshta në Java sipas arkitekturës model-view-controller.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>			
	Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• definojë njohuritë bazë të algoritmeve dhe programimit në përgjithësi</li> <li>• analizojë arkitekturën MVC për të koduar dhe disenjuar aplikacione të thjeshta në Java;</li> <li>• zbatojë njohuri mbi parimet themelore të OOP, strukturën e komponenteve dhe strukturën e kontrollit për të koduar aplikacione të thjeshta në Java;</li> <li>• dizajnojë shabllone elementare algoritmike për të zgjidhur situata të ndryshme problemore;</li> <li>• rekomandojë mënyra më efikase për programimin e bazuar në arkitekturën MVC.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30

Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim			8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			3
Projektet, prezantimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
	Ligjërata, ushtrime numerike, ushtrime laboratorike, punime laboratorike.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	Provimi periodik: 25% Punimi laboratorik: 15% Vijimi i rregullt: 10% Provimi final 50% Total 100%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>			
	1. D. Schmidt, <i>Programming principles in Java: architectures and interfaces</i> , Kansas State University, 2003		
<b>Literatura shtesë:</b>			
	2. J. Schildt, <i>Java 2: The complete reference</i> , McGraw-Hill, 2001. 3. I. Horton, <i>Beginning Java 2</i> , Wrox Press, 2000. 4. P. S. Wang, <i>Java with object-oriented programming</i> , Brooks/Cole-Thomson Learning, 2003.		
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>			
<b>Java</b>		<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>	
<b>Java e parë:</b>		Kompjuterët dhe programimi. Ç'është kompjuteri? Programimi kompjuterik. Programet janë objekte. Sistemet operative dhe Windows. Arkitektura e softuerit	

<b>Java e dytë:</b>	Aplikacionet e thjeshta në Java. Një aplikacion dhe arkitektura e tij. Si ndërtohet dhe ekzekutohet një aplikacion
<b>Java e tretë:</b>	Si funksionon aplikacioni. Si një objekt konstruktin një tjetër. Korrigjimi i mesazheve të gabimeve të kompilatorit
<b>Java e katërt:</b>	Aritmetika dhe variablat. Aritmetika e numrave të plotë. Variablat.
<b>Java e pestë:</b>	Aritmetika e numrave racionalë. Tipi boolean. Stringjet, karakterët dhe operacionet me ta.
<b>Java e gjashtë:</b>	Kontrolli i tipeve të të dhënave. Hyrja me anë të argumentëve programorë. Diagnostifikimi i gabimeve në shprehje dhe variabla. Fjalët kyçe dhe identifikatorët në Java.
<b>Java e shtatë:</b>	Provim periodik
<b>Java e tetë:</b>	Hyrja, dalja dhe gjendja. Hyrja interaktive
<b>Java e nëntë:</b>	Dalja grafike. Formatet dhe metodat për vizatim
<b>Java e dhjetë:</b>	Variablat e fushave. Testimi i programit i cili përmban hyrje
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Struktura e komponenteve: Ndërtimi i metodave dhe klasave. Metodatat. Metodatat publike. Parametrat e metodave
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Case study: kornizë dalëse me destinacion të përgjithshëm. Funksionet. Metodatat private.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Struktura e kontrollit: Urdhërat e kushtit. Rrjedha e kontrollit dhe struktura e kontrollit. Struktura kushtëzuese e kontrollit.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Operatorët logjikë. Zbatimi i urdhërave kushtëzues. Ndryshimi i rrjedhës së kontrollit.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Urdhëri switch. Komponentet model dhe kontrollues. Case study: menagjer kontosh bankiere. Metodatat dhe klasat testuese.

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të Universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test ose provim. Po ashtu përdorimi i celularëve, apo mjeteve tjera elektronike që e pengojnë procesin e mësimin, do të jetë i ndaluar. Vijueshmëria e rregullt është obligative.

## Programimi II

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
Titulli i lëndës:	Programimi II		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I-rë – Semestri II		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Korab Rrmoku		
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:korab.rrmoku@uni-pr.edu">korab.rrmoku@uni-pr.edu</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>			
	Kjo lëndë përfshinë pjesë shtesë të programimit në Java, duke filluar nga elementet që janë thjeshta dhe për të parë më shumë programim në objekte.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>			
	Paisja e studentëve me njohuri mbi elementet e gjuhës java, parimet e gjuhëve të orientuara në objekte, si dhe marrja me përjashtime dhe lëshime.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>			
	Pas përfundimit të kursit, studentët duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të jenë në gjendje të zbatojnë strukturën e kontrollit të përsëritjes si në kontekst të programimit klasik ashtu dhe OOP;</li> <li>• Të jenë në gjendje të zbatojnë vargun si strukturë të dhënash themelore në Java për zgjidhje situatash të ndryshme problemore;</li> <li>• Të jenë në gjendje të zbatojnë shabllone algoritmike për të zgjidhur situata të ndryshme problemore.</li> </ul>		
•			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të	4	15	60

studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			3
Projektet, prezantimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime numerike, ushtrime laboratorike, punime laboratorike.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Provimi periodik 1: 30% Provimi periodik 2: 30% Punimi dhe ushtrimet laboratorike: 25% Provimi final 15%

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	1. D. Liang, Introduction to java programming and data structures, botimi i fundit
<b>Literatura shtesë:</b>	2. J. Schildt, Java 2: <i>The complete reference</i> , McGraw-Hill, 2001. 3. I. Horton, <i>Beginning Java 2</i> , Wrox Press, 2000. 4. P. S. Wang, <i>Java with object-oriented programming</i> , Brooks/Cole-Thomson Learning, 2003.

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në lëndën dhe njoftim me syllabusin e lëndës
<i>Java e dytë:</i>	Përzgjedhja
<i>Java e tretë:</i>	Funksionet matematikore, karakterët dhe stringjet
<i>Java e katërt:</i>	Unazat
<i>Java e pestë:</i>	Metodat
<i>Java e gjashtë:</i>	Vargjet një dimensionale
<i>Java e shtatë:</i>	Provimi i parë periodik
<i>Java e tetë:</i>	Vargjet dy dimensionale
<i>Java e nëntë:</i>	Objektet dhe klasët
<i>Java e dhjetë:</i>	Të menduarit në objekte
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Trashëgimia dhe polimorfizmi
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përrjashtimet dhe hyrjet daljet e programit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Klasët abstrakte dhe interfejsat

<b><i>Java e katërbëdhjetë:</i></b>	Rekurzioni
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></b>	Provimi i dytë periodik
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p>Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të Universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjiarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test ose provim. Po ashtu përdorimi i celularëve, apo mjeteve tjera elektronike që pengojnë procesin e mësimin, do të jetë i ndaluar. Vijueshmëria e rregullt është obligative.</p>	

**SYLLABUSI i lëndës: Statistika**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike:</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës		
<b>Drejtimi</b>	Matematikë		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Statistikë		
<b>Niveli:</b>	Bachelor		
<b>Statusi lëndës:</b>	E obligueshme		
<b>Viti i studimeve:</b>	III		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	3+2		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6		
<b>Koha / lokacioni:</b>	Departamenti i Matematikës		
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Ass. Dr. Edmond Aliaga		
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:edmond.aliaga@uni-pr.edu">edmond.aliaga@uni-pr.edu</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kursi i kushtohet nocioneve bazike statistikore, shpërndarjeve, hipotezave statistikore dhe zbatimeve.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me përpunimin dhe analizën e të dhënave, shfaqjen grafike të të dhënave dhe metodat themelore e procedurat e analizës statistikore të nevojshme për operacione të pavarura, si dhe analiza statistikore e rasteve nga praktika reale e biznesit.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstrojnë aftësitë për të përdorur pako statistikore,</li> <li>• Aplikojnë kompjuterët dhe teknologjitë e tjera të informacionit dhe komunikimit si një ndihmës,</li> <li>• Analizojnë konceptet bazë dhe përkufizimet e probabilitetit dhe statistikat,</li> <li>• Analizojnë rezultatet e hulumtimit,</li> <li>• Kuptojnë rezultatet e analizës së të dhënave,</li> <li>• Njohin nevojën për të përdorur përpunimin e të dhënave statistikore.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit – Semestri II</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata me profesorin	3	15	45
Ushtrime me asistentin	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokuiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj	5	-	5
<b>Totali</b>			<b>155 orë</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime, konsultime.		

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kollokuium):	20%
	Vlerësimi i parë (kollokuium):	20%
	Provimi final:	60%
	Total:	100%

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Kuptimet themelore në statistikë
<i>Java e dytë:</i>	Mënyrat e paraqitjes së të dhënave statistikore
<i>Java e tretë:</i>	Karakteristikat numerike të qendrës së shpërndarjes empirike: mesi aritmetik, mediana, mesi gjeometrik, mesi harmonik
<i>Java e katërt:</i>	Masat e shpërndarjes së të dhënave statistikore: kuartilët, devijimi interkuartil, devijimi mesatar absolut, devijimi standard
<i>Java e pestë:</i>	Momentet, asimetria, masa absolute e asimetrisë, masa relative e asimetrisë
<i>Java e gjashtë:</i>	Zgjedhja e “rastësishme” e mostrës në bazë të “numrave të rastësishëm”
<i>Java e shtatë:</i>	Mesi dhe dispersioni empirik i mostrave, shpërndarja e dendurive në mostra
<i>Java e tetë:</i>	Gama funksioni, shpërndarja $\chi^2$ , shpërndarja e studentit $t(n)$
<i>Java e nëntë:</i>	Testimi i hipotezave statistikore, kuptimet themelore
<i>Java e dhjetë:</i>	Llojet e gabimeve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Hipotezat statistikore parametrike për $\mu$
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Hipotezat statistikore parametrike për $\sigma^2$
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Hipotezat statistikore joparametrike, testi i përputhshmërisë
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Hipotezat statistikore joparametrike, testi i krahasimit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Zbatime
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sh. Leka, Teoria e Probabiliteteve dhe Statistika Matematike , Tiranë, 1998.</li> <li>• F. Daly, D.J. Hand, M.C. Jones A.D. Lunn and K.J. McConway, <i>Elements of Statistics</i>, Addison-Wesley, 1995</li> <li>• R. V. Hogg, J. McKean, A. T. Craig, <i>Introduction to Mathematical Statistics (7th ed.)</i>, Pearson, 2012</li> <li>• Richard J. Larsen, Morris L. Marx, <i>An Introduction to Mathematical Statistics and Its Applications (5th ed.)</i>, Pearson, 2011</li> <li>• R. S. Witte, J. S. Witte, <i>Statistics (9th ed.)</i>, Wiley, 2009</li> </ul>

### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të Universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.

## Strukturat algjebrike

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Matematikës
Titulli i lëndës:	Strukturat algjebrike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III-të
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Rexhep Gjergji
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:rgjergji@yahoo.com">rgjergji@yahoo.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kursi përfshinë: grupet, unazat, fushat, algjebtrat dhe modulet. Në pjesën e parë jepen kuptimet themelore për strukturat (grupet, nëngrupet, nëngrupet normale, faktor-grupi, prodhimi direkt dhe prodhimi semidirekt i grupeve etj.) dhe disa rezultate bazë për homomorfizmet e grupeve. Kapitulli përfundon me shembuj të grupeve me theks të veçantë grupin <math>GL_n</math> dhe disa nëngrupe të saj. Pjesa e dytë përfshinë: Unaza, fusha dhe algjebtrat. Në këtë pjesë së pari shtjellohen unazat, pastaj idealet dhe faktor-unazat e mandej homomorfizmet e unazave. Si një shembull i rëndësishëm mësohet unaza e polinomeve. Në vazhdim studiohen domeni i idealeve kryesor dhe unazat faktoriale. Në vazhdim jepet përkufizimi dhe disa pohime themelore për fushat. Kapitulli përfundon me një shqyrtim të shkurtër të algjebrave, disa shembuj algjebtrash asociative dhe disa shembuj të algjebrave Lie si përfaqësues të klasës së algjebrave joasocijative. Kursi përfundon me Modulet. Aty jepet kuptimi i modulit, nën-modulit, faktor-modulit, modulit të thjeshtë dhe gjysmë të thjeshtë etj. Në fund jepen disa rezultate themelore të teorisë së strukturave dhe disa shembuj bazë të moduleve.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kursit është që të përkufizohen dhe në nivel elementar të studiohen disa nga strukturat bazike algjebrike: Grupet, Unazat, Fushat, Algjebtrat dhe Modulet. Do të shpjegohet edhe rëndësia e tyre për studime në fushat tjera të matematikës, si për shembull teorinë e numrave, teorinë e përfaqësimit etj. Pastaj do të trajtohet paralelizmi mes teorive për struktura të ndryshme.</p> <p>Qasja në studim është nga e përgjithshmja kah ato të veçanta. Prezantimi do të shoqërohet me një numër</p>

	shembujsh konkretë të strukturave algjebrike të cilat ofrojnë bazë dhe motivim për studime të mëtejshme.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• definojë kuptimet themelore për grupet, unazat dhe fushat;</li> <li>• ilustrojë dhe interpretojë kuptimet themelore të këtij kursi;</li> <li>• formulojë rezultatet dhe teoremat e rëndësishme për grupet, unazat dhe fushat;</li> <li>• përshkruajë tiparet kryesore të vërtetimeve të teoremave të rëndësishme;</li> <li>• përdorë teorinë, metodat dhe teknikat nga ky kurs për të zgjidhur problemet në lidhje me grupet, unazat dhe fushat.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokuiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim			8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			3
Projektet, prezantimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>165</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi i rregullt	5 %	
	Seminari	15 %	
	Provimi me shkrim	40 %	
	Provimi me gojë	40 %	
	Total:	100%	
<b>Literatura</b>			

<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. E. Ademaj, E Gashi, Algjebra e përgjithshme, ETMM, Prishtinë, 1986.</li> <li>2. J. A. Gallian, Contemporary Algebra, 7th edition, Brooks/Cole, 2010.</li> <li>3. R. Gjergji, Algjebra e përgjithshme, përmbledhje detyrash të zgjidhura I, 2000, Prishtinë</li> <li>4. R. Gjergji, Algjebra e përgjithshme, përmbledhje detyrash të zgjidhura II, 2002, Prishtinë</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. R. Kochendorffer, Group Theory, London 1970</li> <li>2. B. Gazidede, Algjebra I, ILAR, Tiranë 2006</li> <li>3. B. Baumslag, B. Chandler, Group Theory, Schaum's Outline, McGraw-Hill, 1968</li> </ol>

#### Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<b>Java e parë:</b>	Kuptimi i grupit
<b>Java e dytë:</b>	Shembuj të grupeve
<b>Java e tretë:</b>	Grupet ciklike
<b>Java e katërt:</b>	Homomorfizimi i grupeve
<b>Java e pestë:</b>	Nëngrupet. Nëngrupet normale
<b>Java e gjashtë:</b>	Prodhimi direkt dhe semidirekt i grupeve
<b>Java e shtatë:</b>	Grupin $GL_n$ dhe disa nëngrupe të tij
<b>Java e tetë:</b>	Unazat. Idealet në unaza
<b>Java e nëntë:</b>	Faktor-unazat. Homomorfizmet e unazave
<b>Java e dhjetë:</b>	Unaza e polinomeve
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	idealeve kryesor dhe unazat faktoriele
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	përkufizimi dhe disa pohime themelore për fushat
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	algjebtrat asociative dhe disa shembuj të algjebrave të Liut
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Modulet. Nën-modulet. faktor-modulet. Moduli i thjeshtë dhe gjysmë i thjeshtë
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Rezultate themelore të teorisë së strukturave dhe disa shembuj bazë të moduleve.

#### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të Universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjiaturë, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test. Po ashtu përdorimi i celularëve, apo mjeteve tjera elektronike që e pengojnë procesin e mësimit, do të jetë i ndaluar.

## Strukturat e të dhënave dhe algoritmet

Informatat themelore për lëndën			
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore (FSHMN)		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Strukturat e të dhënave dhe algoritmet		
<b>Niveli:</b>	Bachelor		
<b>Statusi i lëndës:</b>	Zgjedhore		
<b>Viti i studimeve:</b>	II		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2		
<b>Kreditë ECTS:</b>	5		
<b>Koha / Vendi:</b>	N/A, Departamenti i Matematikës, FSHMN		
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof. Ass. Eliot Bytyçi		
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:eliot.bytyci@uni-pr.edu">eliot.bytyci@uni-pr.edu</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Ky kurs është i orientuar drejtë përgatitjes së studentëve me njohuri themelore mbi strukturën e të dhënave në përgjithësi dhe me mbështetje në ushtrime në gjuhën programuese Java. Përveç strukturave të të dhënave (vargjet, listat, hartat, listat e lidhura, stack, queue, bashkësitë, hash tabelat, trungjet) do të shqyrtohen edhe disa aplikime të algoritmeve të kërkimit dhe sortimit. <b>Parakushtet:</b> Programimi I, Programimi II		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kursi ka për qëllim primar që studentët t'i njoftojë me strukturat e të dhënave dhe aplikimet e tyre.		
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbatojnë vargun si strukturë më themelore të të dhënave;</li> <li>- të zbatojnë dhe të dallojnë përfitimet e përdorimit të algoritmeve të kërkimit dhe sortimit;</li> <li>- të njoftohen me disa prej strukturave tjera të të dhënave si listat, listat e lidhura, strukturat stack and queue, pasqyrimet, trungjet, hash tabelat, grafet.</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Përgatitje për test intermediar	-	-	-
Konsultime me mësimdhënësin	1	15	15
Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik	15	1	15
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30

Përgatitja për provimin final	20	1	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	4	1	4
Projektet, prezantimet, detyrat, etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>155</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime laboratorike dhe punë individuale në projekte/detyra/seminare.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kuiz në klasë: 10% Punim seminari: 20% Provimi periodik 1: 35% Provimi periodik: 35%  Nëse studenti nuk e ka kaluar provimin, atëherë hyn në provim përfundimtar për 70% të lëndës.
<b>Literatura primare:</b>	Y. Daniel Liang, Introduction to Java Programming and Data Structures, Comprehensive Version, latest edition
<b>Literatura shtesë:</b>	Goodrich, M. T., Tamassia, R., Goldwasser, M. H. Data Structures and Algorithms in Java. Wiley, 6th edition, 2016 D. Schmidt, Programming Principles in Java, 2003

**Hartimi i planit mësimor**

<b>Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes</b>	
<b>Java 1:</b>	Ndihje me lëndë/ Pasqyrimet, ushtrime dhe ushtrime të grupit dhe në kohë të lira, vëllimet e provime. Ata duhet t'i kontribuojnë një procesi mësimor konstruktiv dhe t'i ndjekin udhëzimet e instruktorit. Studentët inkurajohen të vijnë në konsultime. Detyrat e shtëpisë duhet të shkruhen individualisht, por studentët inkurajohen të bisedojnë me kolegë në lidhje me detyrat me kushtin që shënohen emrat e kolegëve me të cilët është diskutuar dhe/ose resurset që janë përdorur. Pandershmeria akademike do të ndëshkohet sipas rregulloresve të Universitetit. Vijueshmeria e ligjëratave dhe ushtrimeve laboratorike është obligative.
<b>Java 2:</b>	Generikët
<b>Java 3:</b>	Listat
<b>Java 4:</b>	Listat e lidhura
<b>Java 5:</b>	Stack dhe queue
<b>Java 6:</b>	Provimi periodik 1
<b>Java 7:</b>	Pasqyrimet
<b>Java 8:</b>	Bashkësitë
<b>Java 9:</b>	Hash tabelat
<b>Java 10:</b>	Trungjet
<b>Java 11:</b>	Algoritmet e kërkimit
<b>Java 12:</b>	Algoritmet e sortimit
<b>Java 13:</b>	Grafet dhe implementimi
<b>Java 14:</b>	Provimi periodik 2
<b>Java 15:</b>	

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës
<b>Titulli i lëndës</b>	Teoria e gjasës
<b>Niveli</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës</b>	I obligueshëm
<b>Viti i studimeve</b>	II (Sem. III)
<b>Numri i orëve në javë</b>	3+2
<b>Vlera në kredi – ECTS</b>	7
<b>Koha / lokacioni</b>	Departamenti i Matematikës
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	dr. sc. Bujar Fejzullahu
<b>Detajat kontaktuese</b>	e-mail: bujar.fejzullahu@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Në këtë kurs jepen kuptimet dhe pohimet themelore nga teoria e gjasës: hapësira mostër, gjasa dhe gjasa e kushtëzuar, ndryshoret e rastësishme, shpërndarjet e gjasave më të rëndësishme diskrete dhe të vazhdueshme, vektorin e rastësishëm, parametrat numerik, funksioni gjenerues i momenteve, teoremat limite, procesi i Poisson-it. Këto koncepte ilustrohen me shembuj praktikë nga lëmitë e ndryshme shkencore.
<b>Qëllimet e lëndës</b>	Qëllimi i kursit është pajisja e studentëve me njohuri themelore për bazën e ndërtimit aksiomatik të gjasës, ndryshoreve të rastësishme si dhe parametrat numerik përkatës (pritja dhe variansa), funksionin e përbashkët të shpërndarjes për ndryshoreve të rastësishme, shumën e ndryshoreve të rastësishme të pavaruar, teoremat limite.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>	Pas përfundimit të kursit studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegojë dhe zbatojë kuptimet themelore nga teoria e gjasës, duke përfshirë hapësirën mostër, gjasën dhe gjasën e kushtëzuar, pavarësinë e ngjarjeve;</li> <li>• Përshkruajë dhe zbatojë kuptimet e ndryshoreve të rastit diskret dhe të vazhdueshme;</li> <li>• njohë dhe kuptoj vektorin e rastësishëm dhe funksionin përkatës të shpërndarjes së gjasave;</li> <li>• Formulojë dhe zbatojë vetitë e pritjes dhe variansës;</li> <li>• Interpretojë dhe përdorë shpërndarjet themelore: binomiale, Poisson-it, Pascal-it, gama, beta dhe atë normale;</li> <li>• Zbatoj teoremat limite, e në veçanti teoremën qëndrore kufitare;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aplikoj njohuritë e fituara nga ky kurs për zgjidhjen e problemeve nga fushat e ndryshme shkencore dhe jetës së përditshme.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>165</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuime, provime.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Detyrat e shtëpisë (10%), Kollokuiumi i parë (15%), Kollokuiumi i dytë (15%), Testi final (60%). Kriteri i kalueshmrisë është mbi 50% të pikëve të përgjithshme të vlerësimit. Nëse studenti nuk e kalon provimin me kollokuime dhe detyra të shtëpisë, atëherë ai i nënshtrohet provimit me shkrim që peshon 40%, si dhe provimit me gojë që peshon 60%. Kalimi i provimit me shkrim është i domosdoshëm për t'iu nënshtruar provimit me gojë.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	B. Fejzullahu, <i>Bazat e teorisë së gjasës</i> , Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2021.		
<b>Literatura shtesë:</b>	S. Ross, <i>A First Course in Probability</i> , Prentice Hall, New Jersey, 2009. W. Feller, <i>An Introduction to Probability Theory and its Applications I</i> ”, Wiley, New York, 1970.		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hapësira e ngjarjeve elementare-hapësira mostër dhe algjebra e ngjarjeve
<i>Java e dytë:</i>	Aksiomat e gjasës dhe rrjedhimet e tyre. Përkufizimi klasik dhe gjeometrik i gjasës
<i>Java e tretë:</i>	Gjasa e kushtëzuar dhe pavarësia e ngjarjeve. Formula e Bayes-it
<i>Java e katërt:</i>	Ndryshorja e rastësishme dhe funksioni i shpërndarjes të gjasave
<i>Java e pestë:</i>	Ndryshorja e rastësishme diskrete dhe e vazhdueshme
<i>Java e gjashtë:</i>	Vektori i rastësishëm dhe funksioni i përbashkët i shpërndarjes
<i>Java e shtatë:</i>	Shuma e ndryshoreve të rastësishme të pavaruar diskrete dhe të vazhdueshme
<i>Java e tetë:</i>	Parametrat numerik të ndryshoreve të rastësishme: pritja dhe variansa
<i>Java e nëntë:</i>	Shpërndarja binomiale dhe shpërndarja e Poisson-it
<i>Java e dhjetë:</i>	Shpërndarja gjeometrike dhe e Pascal-it
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Shpërndarja gama, beta dhe normale (e Gauss-it)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Funksioni gjenerues i momenteve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Ligji i dobët dhe i fort i numrave të mëdhenjë
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Teorema qëndrore kufitare
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Procesi i Poisson-it

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p>Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjiale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test.</p>

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FShMN, Departamenti i Matematikës
Titulli i lëndës:	Teoria e numrave
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	0
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Kajta H. Bllaca
Detajet kontaktuese:	kajta.h.bllaca@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Teoria e numrave gjithmonë ka zënë një vend të posaçëm në botën e matematikës. Kjo për arsye të rendësisë së padiskutueshme historike të lëndës: ajo është një nga disiplinat e pakta që ka rezultate të demonstrueshme që i paraprijnë vetë idesë së një universiteti.</p> <p>Teoria e numrave merret me studimin e vetive të numrave të plotë. Matematikani i madh Carl Friedrich Gauss, pat thënë për teorinë e numrave (aritmetikën) se është “Mbretëreshë e matematikës”.</p> <p>Shembuj të temave që trajtohen në këtë kurs janë: plotëpjestueshmëria, kongruencat, mbetjet kuadratike, format kuadratike, funksionet aritmetike, ekuacionet e Diofantit.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kursi do të mbulojë konceptet themelore të teorisë elementare të numrave, si dhe tema të zgjedhura nga fushat e tjera të teorisë së numrave.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit pritet që studenti të</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dijë për thyesat e vazhdueshme,</li> <li>• ketë njohuri për shpërndarjen e numrave të thjeshtë,</li> <li>• vërtetojë pohime dhe të zgjidhë detyra që ndërlidhen me teoremën fundamentale në</li> </ul>

	aritmetikë, <ul style="list-style-type: none"> <li>• zgjidhë ekuacionet e Diofantit si dhe të zbatojë ato në zgjidhjen e problemeve të ndryshme,</li> <li>• zbatojë kongruencat në zgjidhjen e detyrave të ndryshme.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokuiume, seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	5	2	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			50
Përgatitja përfundimtare për provim	6	4	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet, etj.	-	-	-
<b>Totali</b>			<b>165</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime, detyra shtëpie, konsultime, kollokuiume, provime.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kollokuiumet, Detyrat e shtëpisë dhe puna seminarike, Aktiviteti në mësim, Vlerësimi përfundimtar.  <b>Kollokuiumet</b>  Dy kollokuiume, secili me pikë maksimale 60; provimet janë me shkrim. Kollokuiumi i parë përfshin përmbajtje që është trajtuar në ushtrimet nga kapitulli për pjesëtueshmëri dhe kongruencë		

Kollokuiumi i dytë përfshin përmbajtjen e përpunuar në ushtrime për funksionet aritmetike, mbetjeve kuadratike, formave kuadratike, dhe ekuacionet e Diophanit.

### **Detyrat e shtëpisë dhe puna seminarike**

Do të jipen dy detyra të shtëpisë (të cilat do të vlerësohen), një në periudhën para kollokuiumit të parë dhe një para kollokuiumit të dytë. Do të jenë detyra të tipit të njëjtë sikur ato që do të bëhen në ushtrime.

Afati i fundit për dorëzim do të jetë një javë. Numri maksimal i pikëve për secilën detyrë është 10 pikë. Detyrat nuk janë të obligueshme. Ata që nuk i zgjedhin do të kenë zero pikë.

### **Aktiviteti në klasë**

Gjatë ushtrimeve rregullisht, dhe në ligjërata herë pas here do të jipen detyra për zgjidhje në mënyrë të pavarur. Studentët të cilët janë të suksesshëm në zgjidhjen e këtyre detyrave, marrin nga 5 pikë për çdo detyrë.

Numri maksimal i pikëve që mund të mbledhen në këtë pjesë është 20. Me 10 pikë të mbledhura, studentët do të kenë mundësinë e lirit nga vlerësimi përfundimtar.

Pjesëmarrja në klasë nuk është e detyrueshme (dmth nuk do të kontrollohen). Sigurisht, që ata që nuk do të marrin pjesë në mësim nuk do të jenë në gjendje për të marrë pikë për aktivitetin në klasë.

### **Provimi përfundimtar**

Provimi është me gojë; verifikohet të kuptuarit e përmbajtjes së trajtuar në ligjërata.

Kushti për hyrje në provimin përfundimtar, është një total prej të paktën 50 pikë të mbledhura në dy kollokuiumet, detyrat dhe aktivitetet në klasë.

Numri maksimal i pikëve të mundshme për të marrë në provimin përfundimtar është 40 pikë.

Studentët të cilët përmes aktiviteteve në klasë mbledhin të paktën 10 pikë nuk e kanë të detyrueshme të hyjnë në provim përfundimtar, por

	<p>mund të marrin notën bazuar në dy kollokuiumet periodike, detyrat dhe aktiviteti në klasë.</p> <p><b>Provimi përmirësues</b></p> <p>Përmisimi i pikëve mund të bëhet më së shumti në njërin nga kollokuiumet ose provimin përfundimtar. Pas kollokuiumit të dytë studentët mund të zgjedhin në cilin kollokuiumit dëshirojnë të përmisojnë pikët.</p> <p>Studentët të cilët nuk janë të kënaqur me rezultatin e vlerësimit përfundimtar dhe të cilët nuk i janë nënshtruar kollokuiumit përmirësues si më lartë mund të hyjnë në test përmirësues të provimit përfundimtar. Ky test do të jetë në të njëjtën kohë të provimit përfundimtar për studentët të cilët kanë kërkuar test përmisues në njërin nga dy kollokuiumet.</p> <p><b>Nota përfundimtare</b></p> <p>Do të mblidhen pikët nga kollokuiumi i parë (max 60 pikë), kollokuiumi i dytë (max 60 pikë), zgjidhjen e detyrave të shtëpisë (max 20 pikë), aktiviteti në klasë (max 20 pikë) dhe provimi përfundimtar (max 40 pikë). (Studentët të cilët janë të liruar nga provimi përfundimtar, do ju mblidhen pikët vetëm nga katër komponentat e para.</p> <p><b>Notat:</b></p> <p style="padding-left: 40px;">     &gt; 90%      nota 10;      &gt; 80%      nota 9;      &gt; 70%      nota 8;      &gt; 60%      nota 7;      &gt;= 45%     nota 6.   </p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. D. M. Burton, <i>Elementary Number Theory</i>, McGraw-Hill Higher Education, 2005.</li> <li>2. K. H. Rosen, <i>Elementary Number Theory and Its Applications</i>, Addison - Wesley, 1993.</li> </ol>

<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. H. Davenport, <i>The Higher Arithmetic</i>, Cambridge University Press, 1999.</li> <li>2. I. Niven, H. S. Zuckerman, H. L. Montgomery, <i>An Introduction to the Theory Numbers</i>, John Wiley &amp; Sons, 1991.</li> <li>3. H. L. Keng, <i>Introduction to Number Theory</i>, Springer Verlag, 1982.</li> <li>4. K. Ireland, M. Rosen, <i>A Classical Introduction to Modern Number Theory</i>, Springer Verlag, 1998.</li> <li>5. T. Nagell, <i>Introduction to Number Theory</i>, Chelsea, 1981.</li> <li>6. U.-A Dudley, <i>Guide to Elementary Number Theory</i>, Mathematical Association of America, 2009.</li> <li>7. W. Sierpinski, <i>Elementary Theory of Numbers</i>, PNW, Varšava; North Holland, Amsterdam, 1987.</li> <li>8. I. M. Vinogradov, <i>Elements of Number Theory</i>, Dover, 1954.</li> </ol>
---------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Plotpjesëtueshmëria
<b>Java e dytë:</b>	Algoritmi i pjesëtueshmërisë. Numrat e thjeshtë
<b>Java e tretë:</b>	Pjesëtuesi më i madh i përbashkët. Shumëfishi më i vogël i përbashkët.
<b>Java e katërt:</b>	Teorema Fundamentale në Aritmetikë
<b>Java e pestë:</b>	Metoda e faktorizimit dhe numrat e Fermas
<b>Java e gjashtë:</b>	Ekuacionel lineare të Diofantit
<b>Java e shtatë:</b>	Kongruencat lineare. Sistemet e kongruencave lineare. Teorema kineze e mbetjeve. Testimi i plotpjesëtueshmërisë
<b>Java e tetë:</b>	Teorema e Uilsonit dhe Teorema e vogël e Fermas
<b>Java e nëntë:</b>	Funksionet aritmetike
<b>Java e dhjetë:</b>	Funksioni i Ojlerit. Vetitë e funksionit të Ojlerit.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Rrënjët primitive dhe rendi
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Ligji i reciprocitetit kuadratik
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Simboli i Lezhandrit dhe vetitë e tij

<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Numrat e përkryer. Numrat Ferma. Numrat e thejeshtë të Mersenit,
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Thyesat e vazhdueshme

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p>Studentët do të vijojnë mësimin me rregull dhe do t'i kontribuojnë atmosferës kolegjinale e profesionale, duke e respektuar Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e tjera të Universitetit e Fakultetit. Në veçanti, studentët nuk do të kenë sjellje që përbëjnë plagjiarizëm, bashkëpunim të palejueshëm, kopjim të testeve nga të tjerët ose lejim i të tjerëve për ta kopjuar testin, mashtrim ose përdorimin i çfarëdo mjeti për mashtrim në test ose provim. Po ashtu përdorimi i celularëve, apo mjeteve tjera elektronike që e pengojnë procesin e mësimin, do të jetë i ndaluar. Vijueshmëria e rregullt është obligative.</p>

## **SYLLABUSI i lëndës: Transformimet e Laplasit**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	FSHMN, Departamenti i Matematikës
<b>Drejtimi</b>	I Pergjithshem
<b>Titulli i lëndës:</b>	Transformimet e Laplasit
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	III(semestri VI)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6
<b>Koha / lokacioni:</b>	Departamenti i Matematikës
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Dr. Sc. Muhib Lohaj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Tel.: (0) 44 220 015
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Ne fillim do te perkufizohet transformimi i laplasit dhe vetite e tij, pastaj aplikimet ne disa funksione speciale si p.sh. funksioni i Hivisajdit, funksioni i Dirakut etj. Tutje do te zbatohen zberthimet ne seri per njehsimin e transformimeve te funksioneve. Do te shpjgohet transformimi i funksioneve te Beselit. Ne vazhdim do te punohen transformimet inverze te Laplasit. Pastaj do te kalohet ne aplikime te ndryshme si ne zgjidhjen e disa ekuacioneve diferenciale si dhe te sistemeve te ekuacioneve diferenciale.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimet themelore te ketij kursi jane njohurite mbi transformimet e Laplasit si dhe transformimet inverze te tyre. Aplikimet e ketyre transformimeve te serite, ne zgjidhjen e integraleve te ndryshme parametrike, pastaj zbatimi i tyre ne zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale te zakonshme si dhe ne zgjidhjen e sistemeve te ekuacioneve diferenciale etj.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që të:</p>

- Gjejë transformet e Laplasit per funksione te ndryshme ,
- Gjejë transformet e Laplasit per disa funksione speciale si p.sh. funksioni i Hivisajdit, Dirakut , funksionet e Beselit etj.,
- Njehsojë transformimet inverze te Laplasit,
- Zbatojë transformimin inverz në zgjidhjen e disa problemeve matematikore,
- Shfrytëzojë konvolucionin në gjetjen e transformimeve inverze te Laplasit,
- Zbatojë transformimet e Laplasit ne zgjidhjen e disa ekuacioneve diferenciale te zakonshme si dhe ne zgjidhjen e disa prej sistemeve te ekuacioneve diferenciale.

#### Kontributi në ngarkesën e studentit –Semestri VI

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata me profesorin	2	15	30
Ushtrime me asistentin	2	15	30
Punë praktike			
Konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim			10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)			3
Projektet, prezantimet, etj			
<b>Totali</b>			<b>152</b>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Transformimi i Laplasit
<i>Java e dytë:</i>	Rendi eksponencial
<i>Java e tretë:</i>	Vetite themelore te transformimeve te Laplasit
<i>Java e katërt:</i>	Disa funksione speciale
<i>Java e pestë:</i>	Zbatimi i serive
<i>Java e gjashtë:</i>	Transformimet e logaritmit dhe logaritmit integral
<i>Java e shtatë:</i>	Transformimet e funksioneve te Beselit
<i>Java e tetë:</i>	Transformimet inverze te Laplasit
<i>Java e nëntë:</i>	Vetite themelore te transformimeve te Laplasit
<i>Java e dhjetë:</i>	Konvolucioni
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Transformimet inverze te funksioneve racionale
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Gama funksionet
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Zbatimi ne zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale te zakonshme me koeficiente konstant
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Zbatimi ne zgjidhjen e sistemeve te ekuacioneve diferenciale
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Ekuacionet e diferences

Literatura bazë:	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hamiti E, <i>Matematika IV</i>, Prishtine 2008,</li> <li>• Joel L.Schif, <i>Laplace Transform, theory and applications</i>, springer 2008</li> <li>• Hamiti E, Lohaj Sh, <i>Matematika IV permbledhje detyrash</i>, Prishtine 2008.</li> </ul>